



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1191 / prot.
12

Tiranë, më 30.9.2025

V E N D I M
Nr. 25, datë 30.9.2025

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 25, DATË 23.10.2017, "PËR
NORMIMIN DHE SHPËRBLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE,
NË ZBATIM TË PROGRAMIT TË FORMIMIT FILLESTAR DHE VAZHDUES
NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS"

Mbështetur në nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 243 dhe 248 të ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"; në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë"; në nenin 124 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; si dhe të ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 11.6.2009, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", (i ndryshuar), me propozim të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues, i mbledhur më datë 30.9.2025,

V E N D O S I:

1. Në pikën 10, paragrafi i parë, pas togfjalëshit "Formimin Fillestar" shtohet togfjalëshi "dhe Vazhdues".
2. Në pikën 12, behën këto ndryshime:
 - në paragrafin e parë, hiqet fjala "raportesh" dhe shtohen fjalët, "dosjesh", "klinika ligjore", "gjyqe imituese".
 - Në pikën a), hiqet fjala "kryesore", shtohet togfjalëshi "e vitit të parë akademik" si dhe hiqet togfjalëshi "përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga Këshilli Drejtues"

- Në pikën b) hiqet fjala “kryesore” dhe shtohet togfjalëshi “ e vitit të parë akademik” si dhe në fund të pikës b) shtohet fjalia “ Gjatë vitit të dytë akademik, preferohet të aktivizohen në mësimdhënie më shumë magistratë (gjyqtarë/ prokurorë) në detyrë.”
- 3. Në pikën 20, togfjalëshi “ në masën 20 euro” zëvendësohet me togfjalëshin “ në masën 40 euro” dhe pas togfjalëshit “një gjykatë tjetër” shtohet togfjalëshi “apo institucione homologe”.
- 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!